

VENDIM
Nr. 118, datë 18.10.2013

PËR EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRISË
“CEZ SHPËRNDARJE” SHA

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave të shoqërisë “CEZ Shpërndaje” sh.a., për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008, të ndryshuar”, vendimit nr. 5, datë 21.1.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për vendosjen e shoqërisë “CEZ Shpërndaje” sh.a. në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë “CEZ Shpërndaje” sh.a., në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë “CEZ Shpërndaje” sh.a.”, neneve 7 dhe 9 të rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 117, datë 8.10.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të administratorit të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndaje” sh.a.”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimet e kandidatëve për administrator të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndaje” sh.a.,

VENDOSI:

1. Emërimin e z. Arben Seferi si administrator i përkohshëm i shoqërisë “CEZ Shpërndaje” sh.a., që të operojë dhe të mirëmbajë pajisjet, pasuritë dhe mjetet monetare, dhe llogaritë bankare të shoqërisë.
2. Të gjitha funksionet dhe kompetencat e administrimit të shoqërisë “CEZ Shpërndaje” sh.a., i kalojnë administratorit të emëruar nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
3. Administratori i emëruar sipas pikës 1 të këtij vendimi, në administrimin e përditshëm të shoqërisë do të zbatojë rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18 pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
4. Administratori i emëruar sipas pikës 1 të këtij vendimi, nuk mund të transferojë asnjë aset ose pasuri materiale të shoqërisë “CEZ Shpërndaje” sh.a., nëpërmjet shitjes, pengut, qirasë, shkëmbimit apo formave të tjera.
5. Depozitimi dhe publikimi i këtij vendimi në të dhënat e shoqërisë “CEZ Shpërndaje” sh.a., me numër NIPT: K72410014H, do të realizohet sipas autorizimit bashkëlidhur këtij vendimi.
6. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë menjëherë administratorin e emëruar sipas pikës 1 të këtij vendimi, shoqërinë “CEZ Shpërndaje” sh.a., QKR-në dhe çdo subjekt tjetër të interesuar për zbatimin e këtij vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti